



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.82 dt.05.06.1998

**MBI
FINANCIMIN NGA TE ARDHURAT E BASHKISE E DREJTORISE SE
QENDRES EKONOMIKE TE ÇERDHEVE PER PAGA, SIGURIME
SHOQERORE, SHPENZIME PER INVESTIME PER VITIN 1998**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.05.06.1998, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mjedisit “Mbi financimin nga të ardhurat e Bashkisë e Drejtorisë së Qendrës Ekonomike të Çerdheve për paga, sigurime shoqërore, shpenzime dhe investime për vitin 1998”, në mbështetje të ligjit Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për Buxhetin Lokal” dhe ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”.

VENDOSI

1. Dhënien e Drejtorisë së Qendrës Ekonomike të Çerdheve për vitin 1998 e fondeve :

Për	- Paga	9.900.000 lekë
	- Sig.Shoq.	4.797.000 lekë
	- Shpenzime	17.600.000 lekë

2. Dhënien e Drejtorisë së Qendrës Ekonomike të Çerdheve të fondit **10.000.000 lekë** për rikonstruksionin dhe shtesën e një kati në çerdhen e fëmijëve Nr.1.

3. Në se krijohet mundësia t'i propozohet **AEDP** të **Fondacionit SOROS** që të bashkojë fondet me ne për të rikonstruktuar dhe godinën e çerdhes Nr.45.
4. Nëpërmjet bisedimeve të përbashkëta me **AEDP** të **Fondacionit SOROS** të përcaktohen montalitetet e bashkëpunimit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mjedisit, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Qendrës Ekonomike të Çerdheve.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI